



Datë: 27.08.2025
Numër Protokolli: 5805/2025

A.nr.697/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.697/2025, të datës 22.04.2025, të parashtruar nga M.S-K, kundër organit të punësimit: Komuna e Suharekës, në çështjen juridike “*shkelje e së drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprobuhet si bazuar ankesa me numër A.nr.697/2025, e datës 22.04.2025, e parashtruar nga ankuesja, M.S-K.

II. Obligohet Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshëm ligjore-administrative, në atë mënyrë që ankuesi t’i bëjë kompensimin retroaktiv të diferencës së papaguar nga data 04.01.2023 deri më 31.12.2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.S-K, (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesja*), më datë 22.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos kompensimit të diferencës në pagë nga organi i punësimit dhe atë për përdhën kohore 01.02.2023 deri 31.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: *Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës, ndërsa kjo e fundit, më datë 03.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: *Kolegji i Këshillit*) **administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2627/2025 të datës 22.04.2025, nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.05.2025; Përgjigjen në ankesë së

bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit më datë 22.05.2025; Akt emërimit më datë 30.12.2022; Akt emërimit nr.112-63/99, të datës 11.11.2024; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 11.11.2024; Listën e pagave Janar-Shkurt 2023; Listën e pagave 2024-2025; Diplomën Nr.1450 të datës 18.04.2012 se bashku me dokumentet tjera për përgatitjen profesionale të ankueses; Kërkesën për korrigjimin e koeficientit; Katalogun e vendeve të punës; Vendimin për organizimin e brendshëm dhe përgjegjësit e organeve të Administratës në Komunën e Suharekës; Aktvendimin me numër protokolli Nr-016-2017 të datës 04.04.2025; Kërkesën më numër protokolli Nr.01-104/15705 të datës 13.03.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur së ankesa e ankueses është e bazuar, **sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja është e punësuar në Komunën e Suharekës, dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.01-112-81615/2022, të datës 30.12.2022, ka qenë e emëruar në pozitën e punës *“Udhëheqëse e Sektorit për Mirëqenie Sociale”*, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale/QPS.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, pozita e ankueses nga organi kompetent në këtë rast Departament për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme **është** ekuivalentuar më klasë GJ28 dhe koeficienti të pagës 5.64. E njëjta, më datë 13.05.2025 ka parashtruar Kërkesë me numër protokolli 06-336 në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, duke kërkuar nga organi i punësimit pagesën retroaktive nga shkurti i vitit 2023 deri në muajin dhjetor 2024, ndërsa, më datë 04.04.2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, përmes Vendimit me numër protokolli Nr.016-20173, ka refuzuar kërkesën e ankueses me arsyetimin se deri në hartimin e Vendimit për miratimin e rregullore për organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Komunën e Suharekës nuk ka qenë e mundur procedimi i kërkesës për koeficientin 7.24.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor se e njëra është pranuar në pozitën e saj si Udhëheqëse e Sektorit të Mirëqenies Sociali nga data 30.12.2022 me klasën e pozitës Drejtues i Ulët, me koeficient 7.5 sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/-196 për Pagat në Sektorin Publik e njëjta nuk ka realizuar koeficient siç përcaktohet më këtë ligj gjegjësisht 7.5, edhe pse institucioni punëdhënës kishte parashtruar kërkesa të vazhdueshme për korrigjim të koeficientit të DMZP-ja. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj organin e punësimit që bëj kompensimin retroaktiv për punën e kryer si Udhëheqëse e Sektorit për Mirëqenie Sociale nga data 01.02.2023 deri më 31.12.2024, konkretisht për 23 muaj.

Në kuptim të themelësisë dhe bazushmerisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenit 2 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,.. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...”* dhe

rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet vetëm në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Në kontekst të konstatimit si më sipër, Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përcakton:

- **Neni 22**, 1. Çdo vend pune në shërbimin civil, është pjesë e një prej klasave në shërbimit civil të përcaktuara sipas kësaj Rregullore. 2. Çdo pozitë konkrete e kategorisë profesionale, klasifikohet si pjesë e një prej tri (3) klasave të kategorisë përkatëse. 3. Klasifikimi i një pozite në kategorinë e profesionale apo të specialistëve bëhet në bazë të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të punës në pajtim nën 21-26 kësaj Rregulloreje.

- **Neni 23**: 1. Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 12 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri.

- **Neni 24**: Vlerësimi për klasifikimin e pozitave të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit.

- **Neni 25**: 1. Grupi i vlerësimit për klasifikim themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit. 2. Grupi i vlerësimit për klasifikim përbëhet nga një përfaqësues i NJMBNJ-së, dhe nga nëpunës tjerë civilë me përvojë në institucionin përkatës.

- **Neni 26** 1. Grupi i Vlerësimit për Klasifikim analizon dhe vlerëson pozitën, harton propozimin për klasifikimin e pozitave dhe paraqet për veprime të mëtejshme tek drejtuesi më i lartë administrativ të institucionit. 2. Pas miratimit nga drejtuesi më i lartë i administrativ i institucionit, propozimi përfshihet në draftin e Rregullores së organizimit të institucionit.

- **Neni 27**: 1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

-**Neni 34**: Dispozitat përfundimtar. Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Rrjedhimisht, bazuar në shkresat rezulton fakti se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, dhe si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, pozita e ankueses nga Departament për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është ekuivalentuar më klasë GJ28 dhe koeficienti të pagës 5.64, ekuivalentim që bazohej vetëm më koeficientin e vjetër të pagës e jo në klasë dhe kategori të pozitës. Ndërsa, Komuna e Suharekës deri më datë 07.11.2024, nuk kishte miratuar rregullore për klasifikimin e vendeve të punës së nëpunësve civilë në këtë komunë, rrjedhimisht me datë 07.11.2024, Komuna e Suharekës ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës në Komunën e Suharekës dhe sipas shtojcës nr.1 të kësaj rregullore gjegjësisht pika 13, pozita Udhëheqëse e Sektorit të Mirëqenies sociale është klasifikuar në klasën Drejtues i Ulët, klasë të

pagës Gj4-7.24, kurse pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, ankueses i është lëshuar Akt Emërimit me numër protokolli 01.Nr.112-63199, i datës 11.11.2024, kategoria e ulët Drejtuese, me klasë dhe koeficient të pagës Gj4-7.24, dhe së ankuesja nga janari 2025 realizon pagës sipas këtij koeficienti.

Andaj, duke u bazuar në kuadrin ligjor si më lartë, Kolegji vlerëson së ankueses në mënyrë të padrejtë i është mohuar e drejta në realizim të pagës, si një e drejtë bazike nga marrëdhënia e punës, dhe atë sipas koeficientit të përcaktuar më ligjin për paga, sepse pozita e ankueses si Udhëheqëse e Sektorit sipas shtojcës 1/5 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e zbatueshëm në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është kategorizuar si pozita e nivelit të ulët drejtues ekuivalente për pozitën e udhëheqësit të divizionit në ministri dhe institucione tjera, klasifikim ky i njëjtë edhe më shtojcën 1.3 të Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshëm nga data 28.02.2024. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit pala ankuese kishte pësuar dëm në kompensime të drejtë të plagës si pasojë e mos korrigjimeve nga njësia kompetente për zbatim të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili bazohej vetëm në nivel të koeficientit të pagës dhe si pasojë e mos nxjerrjes së rregullores nga vet institucioni punëdhënës lidhur me klasifikimin e pozitave të nëpunësve civil të këtij institucioni, përkundër obligimit ligjor të përcaktuar më pikën 6 të Vendimit të Qeverisë Nr.04/128 të datës 16.02.2023 dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 dhe Rregullores (QRK)Nr.06/2024 për Klasifikim e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara dhe si rrjedhojë duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.697/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.S-K;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Suharekës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.